



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 11, nenit 12, paragrafi 12.2, pika c dhe nenit 40, pika 40.2, shkronja a të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 5, shkronja i e Ligjit nr. 03/L - 068, për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, dhe të dispozitave të nenit 34, pika 34.1, shkronja c e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 27.09.2019, miratoi këtë

**RREGULLORE
PËR
NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN E
PUNËS NË SHKOLLA FILLORE TË MESME TË ULËTA DHE TË MESME TË
LARTA
01. nr. 031-142411, dt. 09.06.2016**

Neni 1

1. Neni 32 të Rregullores, i shtohet paragrafi:

32.6. Personeli (mësimdhënësit, punonjësit e shërbimeve profesionale dhe teknike), kanë të drejtë të kërkojnë pensionim të parakohshëm, më 70% të pagës bazë, duke filluar nga mosha 60 vjeçe, si rezultat i gjendjes së rëndë shëndetësore, të cilën duhet ta dokumentojnë me raporte shëndetësore.

2. Neni 67 të Rregullores, i shtohet paragrafi:

67.11. Pensionim të parakohshëm nga mosha 60 vjeçare, me 70% të pagës bazë në rast të mos shfrytëzimit të drejtës së tij nga neni 32, paragrafi 32.6.

Neni 2

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-012/01-239126/19, më 30.09.2019

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

